

Data 14.09.2022

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Studim Projektim: Studim Projektim: “Rikonstruksion i Digave dhe veprave të shkarkimit të rezervuareve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

(CPV): 71221000-3 Shërbim për projektim

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **47,875,000** (dyzet e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë) **lekë pa tvsh**, Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **407,828.60** Euro

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 13/09/2022 është 117.39 Lekë/Euro*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”

si dhe ne mbeshetjet e nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas pikes 1 te shtojces 11 (Kriteret e Pergjithshme per Kualifikim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është “Sherbim Konsulence”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë ne mbeshetjet e nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku percaktohet se: “40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë ne mbeshetjet e nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: “ Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim

Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas kësteve, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2021 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.1 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- a) Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike;
- d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- c) 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.
- d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;
- b) Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme;
- c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
- d) Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit;
- f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.;
- g) Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa;
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.;
- j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- a) Projektim diga të mëdha
- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- d) Projektim vepra ujitje-kullimi-impiane vaditëse-diga të vogla-damba, sifona, kaskada, kapërdredhës, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino

f) Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi, shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuaret, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrje e ujit me puse

6. PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA

a) Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

a) Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale
- c) Sistemet GIS

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët
- e) Studime e projektme hidrogjeologjike.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- c) Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj.
- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime
- d) Projektim sinjalistike ndricuese në infrastrukture.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

- a) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- c) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.
- e) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkriфта me mundësi lëngëzimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Për arsye të vështirësisë së objekteve të kontratës, rehabilitimi i rezervuarëve në Bashkinë e Tiranës, rëndësisë strategjike të tyre në pikëpamjen bujqësore po dhe si pika atraksioni, si dhe problematikat e shfaqura në vite që lidhen me ndërtimin e zonave të banuara poshtë zonave të sigurisë së digave, zona me infrastrukturë ekzistuese mbi dhe nëntokësore, si dhe kërkesave për garancinë e funksionimit dhe cilësisë së tyre sipas standarteve bashkëkohore, të paisura me elemente inovative të eficientës dhe energjisë, vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

| <i>KATEGORIA KËRKUAR</i> | <i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i> | <i>ARGUMENTIMI</i> |
|--------------------------|--|---|
| 2 – a | Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike; | Bazuar në termat e referencës, rezervuarët kanë godina shërbimi dhe të ruajtjes të cilat do të jenë pjesë e rikonstruksionit si pjesë përbërëse e skemës së funksionimit të tyre. Këto trajtohen si elementë industrialë. Gjithashtu mund të gjykohet gjatë procesit të projektimit që këto basane ujore të shoqërohen me elementë arkitekturor me funksion turistik si rrjedhojë, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 2 – d | Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe. | Bazuar në termat e referencës, digat janë gjithashtu sipërfaqe të gjelbëruara të cilat mbas ndërhyrjeve për përforcimin do të kërkojnë projekte të sistemimit të këtyre sipërfaqeve, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 3 - a | Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate. | Bazuar në termat e referencës, rezervuarët kanë godina shërbimi dhe të ruajtjes të cilat do të jenë pjesë e rikonstruksionit si pjesë përbërëse e skemës së funksionimit të tyre. Gjendja e tyre do të kërkojë elemente strukturalë përforcues ose struktura të reja nga e para, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me |

| | | |
|------------|--|--|
| | | sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 3-c | 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët. | Bazuar në termat e referencës, digat dhe shpatet anësore të rezervuarëve do të kërkojnë përforcime konstruktive të domosdoshme të cilat përfshihen në këtë pikë të licencës, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 3-d | Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike; | Bazuar në termat e referencës, digat dhe shpatet anësore të rezervuarëve do të kërkojnë përforcime konstruktive të domosdoshme, gjithashtu edhe godinat e shërbimit dhe ruajtjes, të cilat përfshihen në këtë pikë të licencës, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-a | Projektim të instalimeve hidro-termosanitare; | Bazuar në termat e referencës, godinat, pjesë e projektit, parashikohen për funksionin që do të kryejnë të kenë sisteme të plota të instalimeve hidro sanitare (tualet, funizim me ujë etj), si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-b | Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; | Bazuar në termat e referencës, godinat do të propozohen të kenë panvarësi të sistemeve elektrike nëpërmjet prodhimit të saj nga impiante të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme si psh panelet diellore, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-c | Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; | Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të rehabilitimit, parashikohet për funksionin që do të kryejnë të kenë sisteme të plota të instalimeve elektrike, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-d | Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit; | Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të rehabilitimit, parashikohet të jenë të paisur me internet i cili mund të instalohet nëpërmjet kabllove optikë ose sistemit ëirles, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-f | Projektim të sistemeve kundra zjarrit.; | Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të rehabilitimit, parashikohet të jenë të pajisura me sisteme të mbrojtjes kundra zjarrit dhe sidomos në situatat e rënduara gjatë sezonit të verës këto sipërfaqe ujore mund të shërbejnë si depozita natyrore për shuarjen e zjarreve, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-g | Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa; | Bazuar në termat e referencës, rezervuarët kanë domosdoshmëri sistemet e monitorimit dhe automatizimit industrial të mbushjes dhe shkarkimit sipas motit, si |

| | | |
|--------------|--|--|
| | | rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-i | Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.; | Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve rurale apo urbane në varësi të rezervuarit dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, të cilat do të kenë ndricim, gjithashtu dhe diga me godinën parashikohet të kenë ndricim, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 4-j | Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale. | Bazuar në termat e referencës, godina pjesë e projektit të rehabilitimit në kuadër të kësaj procedure do të jenë te pajisuara me të gjithë sistemet teknike të nevojshme për funksionet që do te realizojnë përfshirë, sistemin e internetit, kamerat e sigurisë, sistemet e alarmit për dedektimin e zjarrit etj. si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 5 - a | Projektim diga të mëdha | Bazuar në termat e referencës, sipas Rregjistrimit të Shfrytëzimit të Digave të publikuar në vitin 2020 nga Komiteti Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) numërohen 38 rezervuarë në Bashkinë e Tiranës. Lartësia e digave varon nga 16m deri në 30m dhe sipërfaqet ujore variojnë nga 550 000 m ³ deri në 9 000 000 000 m ³ .Sipas Ligjit Nr 8681, datë 2.11.2000 dhe sipas ICOLD(International Commission on Large Dams), buletini 148, 2016, “Vepra hidroteknike të përcaktuara si “diga të mëdha”, me lartësi midis 10 dhe 15 m, që plotëson një nga kriteret e mëposhtme: 4.1. Me gjatësi dige më të madhe se 500 m; 4.2. Me kapacitet të rezervuarit më të madh se 1 milion m ³ ; si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 5-b | Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi. | Bazuar në termat e referencës, për realizimin e ndërhyrjeve të parashikuar në rezervuare dhe sistemeve të shkarkimit të ujrave dhe meqënëse kemi të parashikuar gjithashtu dhe infrastrukture të brendëshme rrugore si dhe rikonstrukcion i godinës parashikohet realizimi kolektorëve të shkarkimi, furnizimi me ujë, etj, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 5-d | Projektim vepra ujitje-kullimi-impianete vaditëse-diga të vogla-damba, sifona, kaskada, kapërdredhës, rrymëshpejtues, priza, | Bazuar në termat e referencës, diga ka edhe elemente si shkarkues, ujeleshues, kaperderdhes dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |

| | | |
|--------------|---|--|
| | baraze, porta, tombino | |
| 5-f | Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi, shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuaret, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrje e ujit me puse | Bazuar në termat e referencës, diga ka elemente të tilla si vepra e marrjes, shkarkues të ujërave të tepërta si dhe vepra të marrjes së ujit nga rezervuaret si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 6 - a | Projektimi rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane kryesore | Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve rurale apo urbane në varësi të rezervuarit dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 7-a | Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m | Bazuar në termat e referencës, rezervuaret mund të kenë vepra arti të ndryshme si tombino ose ura të vogla të kanali i ujeleshuesit dhe në elementet e thjeshte të diges si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 8 – a | Rilevime inxhinierike | Bazuar në termat e referencës, kemi realizimin e rilevimeve të gjendjes ekzistues të rezervuarëve, rrugëve skarpateve, etj si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 8 – b | Rilevime inxhinierike kadastrale | Bazuar në termat e referencës, kemi realizimin kadastral të rezervuarëve, rrugëve skarpateve, etj të gjithë infrastrukturën e sipërpërmendur, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 8 - c | Sistemet GIS | Bazuar në termat e referencës, kemi realizimin e rilevimeve duke përdorur sistemin GIS të gjendjes ekzistues të rezervuarëve, rrugëve skarpateve, etj si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 9 – a | Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trullit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate. | Bazuar në termat e referencës, projektimi i godinave të shkarkimit dhe ruajtjes cilësohet si i një rëndësie të vecantë, dhe zhvillimi i tyre në lartësi, parashikohet në lartësi, deri 2 kate, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 9 – d | Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët | Bazuar në termat e referencës parashikohet të bëhet një vlerësim dhe nderhyrjet përkatëse në basenin ujëmbledhës si edhe shpateve dhe trojeve që e kufizojnë ato. Duke marrë në konsideratë këto fakt vlerësimi gjeologjik për këto kategori |

| | | |
|---------------|--|--|
| | | eshte i justifikuar pasi do kemi te bejme me sigurimin e qendrueshmerise se trojeve dhe te vete diges etj. |
| 9-e | Studime e projektme hidrogeologjike. | Bazuar në termat e referencës, për rikonstrukcionin e rezervuarit është e nevojshme të bëhet vlerimi i detajuar i gjendjes hidrogeologjike të vepres dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 10 - c | Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj. | Bazuar në termat e referencës dhe gjithashtu në strategjinë e efikasitetit të energjisë, prodhimin e energjisë së rinovueshme, parashikohet që objektet dhe impiantet e infrastruktures së rezervuarit të kenë pjesë integrale të tyre instalimin e impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike–diellore–era etj. Me qëllim përdorimit të tyre për furnizim alternativ me energji, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 10 – e | Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm. | Bazuar në termat e referencës objektet dhe impiantet e infrastruktures së rezervuarit që parashikohen të realizohen ose rikonstruktohen do të furnizohen me energji elektrike ashtu si kurse dhe ndricimi rrugor, furnizim ky i cili do të sigurohet nga realizimi i kabinave elektrike me linja të tensionit të ulët dhe të mesëm për furnizim, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 11 – a | Projektim sinjalistike jo ndricuese, në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkime. | Bazuar në termat e referencës meqenëse si pjesë e diges dhe në termet e rezervuarit parashikohet realizimi i rrugëve dhe shesheve të brendshme është e nevojshme parashikimi i realizimit të sinjalistikës jo ndricuese, tabelave dhe vijezimit horizontal si pjesë integrale e projekteve të infrastruktures rrugore e jo vetëm, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 11 – d | Projektim Sinjalistike Ndricuese në Infrastrukturë. | Bazuar në termat e referencës, parashikohet që të bëhet rikonstrukcioni i rezervuarit përfshirë edhe pajisjen me sinjalistike ndricuese të kurores së diges si edhe elementeve shenjës të pajisjeve të matjes në dige dhe në basen, sinjalistikës rrugore ndricuese, drita pulsuese etj, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 12 – a | Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike | Bazuar në termat e referencës, kërkohet domosdoshmërisht vlerësimi dhe studimi sizmik për vlerësimin e kapacitetve për |

| | | |
|---------------|--|--|
| | për klasifikimin gjeosizmik të trojeve. | të përcaktuar skemën e ndërhyrjes dhe shkallën e dëmeve, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. |
| 12 – c | Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj. | Bazuar ne termat e references parashikohet te realizohen ose rikonstruktohen godina rruge te brendshme, sheshe dhe sipërfaqe rekreative. Rruget do te sherbejne si pjese e qarkullimit te brendshem te mjeteve dhe kembesoreve dhe si rrjedhoje vleresimi sizmik per kete kategori eshte i justifikuar pasi do kemi te bejme me vepra te infrastruktures rrugore per te cilat pritet te kete dhe integrim me infrastrukture ekzistuese etj |
| 12-e | Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrufta me mundësi lëngëzimi. | Bazuar ne termat e references parashikohet te behet nje vleresim dhe nderhyrjet perkatese ne basenin ujembledhes si edhe shpateve dhe trojeve qe e kufizojne ate. Duke marre ne konsiderate kete fakt vleresimi sizmik per kete kategori eshte i justifikuar pasi do kemi te bejme me sigurimin e qendrueshmerise se trojeve dhe te vete diges etj |

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet të dorëzojnë pranë AK, përpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështiresie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilin kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i profilit Strukturist do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndërtimi**, pjesë e stafit teknik.
- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilin gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) Arkitekti** si staf teknik (arkitekte godinash, peisazhi, etj).
- Punimet për studimin dhe vlerësimin gjeologjik do të jenë të pranishme kryesisht në vlerësimin gjeologjik për vlerësimin dhe rikonstruksionin e shpatëve të rezervuarit dhe kryesisht të digës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 një inxhinieri gjeolog** si staf teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) gjeodet** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë volumi më i madh në këto projekt. Inxhinieri hidroteknik do të jetë i pranishëm për realizimin e rikonstruksionit të elementeve të digës, sistemet e funksionimit të rezervuarëve përfshirë ujeleshuesit, kolektore shkarkimi etj, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri hidroteknik** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimet e projektimit të sistemeve mekanike do të jenë dhe pasqyrohen me anë të sistemeve të projektimit të portave, sistemeve mekanike të sinjalistikës ndricuese dhe jondricuese për infrastrukturen etj, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri mekanik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri elektrik**, si pjesë e stafit teknik.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinierë Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik/Gjeofizik/Sizmiolog;

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf;
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës;
- 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen. Meqenese kemi te bejme me rikonstruksion e nje objekti kompleks sic jane digat dhe rezervuaret perkates prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht;

- Punimet per sherbimin e projekteve strukture kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i profilit Strukturist do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) inxhinier ndertimi** , pjese e stafit ndihmes.
- Punimet per sherbimet qe ofrohen nga inxhinieri gjeoteknik/ gjeofizik/ sizmiolog bazuar pikave te licenses se kerkuara konkretisht per punime dhe vleresime te inxhinierise gjeologo – sizmike, vleresimet gjeoteknike te trojeve do te jene te nevojshme te realizohen, konkretisht ne kete

objekte meqenese kemi ndertesa te reja ose qe do te rikonstruktohen si dhe vleresim dhe rikonstrukcion te shpateve trojeve dhe digave lind nevoja e prezences se **1 nje specialisti inxhinier gjeoteknik/ sizmiolog/ inxhinier gjeofizik** si staf ndihmes per kategorine e sipercituar per vleresimin gjeoteknik – sizmiologjik.

- Punimet per studimin dhe vleresimin gjeologjik do te jene te pranishme kryesisht ne vleresimin gjeologjik per vlersimin dhe rikonstrukcionin e shpateve te rezervuarit dhe kryesisht te diges, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri gjeolog si staf ndihmes.**
- Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet/markkshajder/topograf** si pjese e stafit ndihmes.
- Punimet per sherbimin e projektimit hidroteknik do te jene volumi me i madh ne kete projekt. Inxhinieret hidroteknik do te jene te pranishme per realizimin e rikonstrukcionit te elementeve te diges, sistemet e funksionimit te rezervuareve perfshire ujeleshuesit, kolektore shkarkimi etj, si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca e te pakten **2 (dy) inxhinieri hidroteknik** si pjese e stafit ndihmes.
- **Eksperti zjarrfikes** eshte i domosdoshem te jete prezent gjate hartimit te projekteve te mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vleresimeve perkatese te fushes bazuar ne termat e references
- Punimet per sherbimet e projektimit te sistemeve mekanike do te jene dhe pasqyrohen me ane te sistemeve te projektimit te portave, sistemeve mekanike te sinjalistikes ndricuese dhe jondricuese per infrastrukturen etj, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri mekanik**, si pjese e stafit ndihmes.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve te telekomikacionit , internet, telefoni, radiofoni, sisteme audio vizive, te monitorimit te sistemeve etj parashikohen bazuar ne termat e references. Si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.**
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit ndihmes.
- **1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohet si i domosdoshem pre realizimin e VNM (Vleresimet e ndikimit ne Mjedis) per projektet qe do te realizohen

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar
- b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerrohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhen e fundit të deklaruar.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet të dorëzojnë pranë AK, përpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin që pritet të jete I angazhuar ne keto procedura.*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese Certifikatat të përshtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si më poshtë:

- a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;
- b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;
- c) ISO 50001-2011, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë;
- d) PAS 99:2012, Sistemi i Menaxhimit të Integruar

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë*

të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- *1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;*
- *1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.*

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.